



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 27
Prishtinë, më 6 Maj 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225
Mbledhja filloi në orën 10:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Rustem Mustafa, Bojan Stojanovič, Shkumbin Demaliaj, Emrush Xhemajli, Eqrem Kryeziu, Melihate Termkolli, Gani Geci, Agim Veliu, Zafir Berisha dhe Ibrahim Selmanaj.

Mungoi: Zylfi Merxha.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Blerina Pula.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të datës **28.04.2009**
3. Informim nga Drejtori i Policisë së Kosovës, z.Sheremet Ahmeti
4. Të ndryshme

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 28.04.2009

Procesverbali i datës 28.04.2009 u miratua pa vërejtje

3. Informim nga Drejtori i Policisë së Kosovës, z.Sheremet Ahmeti

Kryetari i Komisionit - tha, në mbledhjen e fundit të Komisionit jemi pajtuar që ta ftojme drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës z.Sheremet Ahmetin që të raportoj hollësisht për rastin që ka ndodh. Drejtori i përgjithshëm z.Ahmeti ka dërguar përfaqësuesit e tij z.Riza Shillova me bashkëpunëtorët e tij. Para se të vazhdojmë a dëshiron dikush ta marr fjalën?

Shkumbin Demaliaj – Unë mendoj që ky takim nuk është adekuat për shkak të mos prezencës së drejtorit të përgjithshëm z.Ahmeti. Në dispozitë ligjore thotë se ai është përgjegjës për të gjitha që ndodhin në Policinë e Kosovës. Nëse dëshironi ne vazhdojmë takimin por mos prezenca krijon një defekt dhe zbrazëti të madhe por edhe injorim të institucioneve.

Kryetari i Komisionit – tha, unë po procedoj tani takimin me përfaqësuesit e Policisë së Kosovës. Vetëm desha t’iu njoftoj se anëtarët e komisionit kanë të drejtë të shtrojnë pyetje dhe të japin komente. E keni pasur një pyetësor dhe do ta keni fjalën në fillim.

Riza Shillova – Ju faleminderit z. Kryetar. Ju kërkoj falje për mos prezencën e drejtorit të policisë, për shkak se gjendet në vizitë zyrtare në Mal të Zi, takim i cili ka qenë i pre notuar më herët. Më konkretisht, sot këtu janë prezent ndihmës drejtori për çështje të hetimit të krimit z.Kadri Arifi, përgjegjës i departamentit të hetimit të krimit, nënkolonel Barlet Gashi, i cili njëkohësisht është nën udhëheqjen e grupit Task Forc, të themeluar nga drejtori i përgjithshëm për tu marr me rastin në fjalë. Në këtë raport ne jemi mbështetur në pikat në të cilat edhe ju keni kërkuar të fokusohemi. E para përveç institucioneve vendore janë të përfshira edhe ato ndërkombëtare në zbardhjen e rastit.

Z.Riza Shillova, gjatë fjalës së tij e prezantoi raportin e Policisë së Kosovës ne lidhje me rastin në fjalë. Këtë raport do ta gjeni të bashkangjitur me procesverbal.

Kryetari i Komisionit - tha, unë kam dy pyetje: e para se a ekziston evidencë në të kaluarën se çka ka pas në atë dhomë dhe a e dini saktë se çka mungon, si dhe në bazë të cilit ligj apo rregullore krijohet Task Forca?

Riza Shillova – Sigurisht që ka pas inventarizim të materialit dhe në bazë të tyre është përcaktuar se çka mungon. Drejtori i Përgjithshëm në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisive që ka për nxjerrjen e akteve nënligjore që dalin nga ligji ka autoritet dhe autorizim që të formojë një grup të veçantë hetimor për raste të veçanta. Për ta ngritur

nivelin e kujdesisë është formuar një grup i veçantë për të hetuar rastin që po e quajmë Task Forca.

Emrush Xhemajli – Unë vetëm desha të di për shumën 6.500.000 lira turke sa është vlera në euro? Ndërsa sa i përket mos ardhjes së drejtorit të përgjithshëm ajo është problemi i tij, sepse krimi ka ndodh në vendin më të rëndësishëm dhe pasojat për këtë janë të mëdha sepse është luhat besimi te qytetarët.

Kadri Arifi – Unë jam ndihmës drejtor i përgjithshëm për hetime të krimit në Policinë e Kosovës. Sa i përket Task Forcës, këtu bëhet fjalë për një grup punues që krijohet brenda një organizate nga zyrtarë të ndryshëm, që një rast të caktuar apo një operacion i caktuar të kryhet në mënyrë sa më profesionale. Sa i përket valutës turke ne saktë nuk e dimë sa është vlera.

Melihate Termkollli – Unë mendoj se kjo çështje është mjaft serioze dhe për këtë arsye kam kërkuar të debatohet në parlament. Me gjithë respektin për zyrtarët, debati në këtë nivel është i papranueshëm, sepse këta nuk janë ata që duhet të japin përgjigjen e plotë për këtë çështje. Unë kërkoj që nëse nuk është drejtori të ftohet Ministri i Punëve të Brendshme. Unë asnjëherë nuk do të pranoj që t'i ulët niveli i institucionit.

Agim Veliu – Edhe unë mendoj se është një goditje shumë e rëndë që i ka ndodhë një institucioni të shtetit. Unë desha të dijë nëse ka të dyshuar deri tani, a ka të ndaluar dhe kur jemi te përgjegjësia morale a ka reflektuar dikush?

Riza Shillova - Është prioritet në strukturat e policisë, konkretisht për përgjegjësit kryesore dhe për pjesën e ndershme, e cila është kompetente për fillimin e hetimeve dhe të punoj në drejtim të zbardhjes së rastit dhe prurjen e përgjegjësve para drejtësisë. Askush nuk dëshiron ti ikë përgjegjësisë, sepse edhe nëse dëshiron janë institucionet ato që nuk lejojnë për shkak të mekanizmave të kontrollit të instaluar dhe janë funksionale sot.

Kadri Arifi – Hetimin e rastit në aspektin taktikë-operativ është duke e udhëhequr drejtori i drejtorisë për hetimin e krimeve të rënda. Nuk bëhet fjalë për injorim të njërive të specializuara të hetimeve. Ne jemi duke e hetuar rastin nga niveli më i lartë i hetimeve në vendin tonë. Sa i përket pistave të dyshimit më lejoni të them se të ndaluar nuk e kemi asnjë person. Të dyshuar ka dhe ekzistojnë pistat ku ne i kemi orientimet tona. Kemi një numër të madh të veprimeve hetimore që nënkuptojnë shenja të gishtërinjve, analiza të ADN-së dhe për këtë ju siguroj se janë duke u marr veprime profesionale.

Gani Geci – Unë i kam dy pyetje në lidhje me këtë rast se a bëhet fjalë edhe për dokumente apo vetëm për këto që janë të shënuara në raport dhe e dyta si bëhet kontrollimi i policëve të Kosovës që hyjnë në objekt. Desha të dijë se cilin e konsideroni më polic atë që e kontrollon policin te hyrja apo vet policin që hyn në objekt?

Kadri Arifi – Policët e sigurimit e kryejnë punën e vet në bazë të përshkrimit të vendit të punës. Ndërsa sa i përket dokumenteve, nuk është marr asnjë dokument.

Shkumbin Demaliaj – Kryetar, unë kërkoj që së pari të verifikohet se a është Drejtori i përgjithshëm i Policisë jashtë vendit. Dhe kisha një pyetje në lidhje me rastin në fjalë, se ky rrjet a ka lidhje me zhvillimet që kanë ndodh në bankën Procredit?

Kryetari i Komisionit - tha, se nuk ka nevojë për të dhënë përgjigje në këtë pyetje sepse hetimet ende nuk janë kryer.

Ibrahim Selmanaj – Kjo që ka ndodh në një mekanizëm të besueshëm për qytetarët është një shqetësim. Një prej defekteve në takimin e sotëm është mungesa e Drejtorit të përgjithshëm të Policisë. Pyetja ime është se a janë shtuar masat e sigurisë në dhomën e dëshmimeve dhe a janë shtuar masat e hetimeve në terren? Dhe në fund pse nuk jep përgjegjësi niveli më i lartë i policisë për këtë rast?

Riza Shillova – Askush nuk do ti ik përgjegjesisë, mirëpo është në proces hetimi i rastit. Ne konsiderojmë përgjegjësi kryesore sot hetimin dhe zbardhjen e rastit. Kjo është përgjegjësi e institucioneve, përgjegjësi ligjore, dhe morale. Në bazë të sistemit se si është krijuar nuk ka mundësi askush ti ik përgjegjesisë.

Kadri Arifi – Masat e sigurisë janë shtuar në objekt dhe në ambientet tjera të drejtorisë së përgjithshme. Ne kemi dështuar në marrjen e masave para ndodhjes së rastit mirëpo ne kemi reaguar.

Zafir Berisha – Meqenëse ky takim është i hapur, shumëçka nuk mund të thuhet. Unë mendoj se organet më të larta të policisë është dashur të jenë të përgatitura për këto sulme. Duhet të bëni një angazhim shumë serioz që të kthehet besimi i qytetarëve ndaj institucionit më të shenjtë. Mesazhi i tillë është jo i favorshëm për policinë dhe shtetin e Kosovës.

Melihate Termkoll – Takimi duhet të mbahet në nivelin e paraparë me rregullore dhe nivelin e paraparë politik për shkak të peshës që ka kjo çështje. Unë kërkoj të thirret Drejtori i Përgjithshëm dhe Ministri i Punëve të Brendshme.

Bojan Stojanovič – Së pari desha t’iu falënderoj që e keni pranuar ftesën. Unë desha të di që se a ka ndonjë plan dhe a bisedoni ju me ata që dëshirojnë ti ikin përgjegjesisë . Unë mendoj se duhet ti jepet një afat prej 15 ditëve dhe pastaj të japin dorëheqje. Kush bën gabime duhet të dënohet për vepra penale. Mendoj se ka probleme në Policinë e Kosovës. Dëshiroj të di se cili është plani juaj këto 15 ditët e ardhshme.

Me kërkesën e anëtarëve të komisionit takimi me përfaqësuesit e Policisë së Kosovës është ndërpre dhe ka vazhduar vetëm me anëtarët e komisionit.

Kryetari i Komisionit - tha, ne si komision mund ti japim rekomandimet tona. Si rekomandim i imi është mu kërkuar përgjegjësia e drejtorit z. Sheremet Ahmetit.

Emrush Xhemajli – Unë shoh një mos gatishmëri të Policisë së Kosovës ti nënshtrohet kontrollit parlamentar. Unë mendoj se duhet të kërkohet përgjegjësia e drejtorit të përgjithshëm, sepse është luhatur besimi i qytetarëve.

Shkumbin Demaliaj – Të gjitha rekomandimet të cilat të dërgojnë në një konkluzion meritor është ardhja e Drejtorit në një seancë dëgjimore. Ne në kuvend duhet ta ngrisim një komision hetimor.

Melihate Termkollli – Rekomandimi i parë është që të mbahet seancë për çështjen e sigurisë në Kosovë. Përgjegjësia të mos ndalet te drejtori i policisë por të jetë e Qeverisë sepse po flasim për sundimin e ligjit.

Zafir Berisha – Kjo çështje të ngrihet në nivel më të lartë dhe ky takim është dashur të jetë i mbyllur sepse ne duhet ti dimë detalet.

Gani Geci – Unë kam kërkuar edhe në seancë që të krijohet një komision i veçantë për hetime. Duhet të kërkohet përgjegjësia në nivel më të lartë.

Ibrahim Selmanaj – Propozoj që të ketë një afat kohor të veprimit vet Ministri dhe të vejë sistem të kontrollit mbi mbarëvajtjen e hetimeve dhe zhvillimin e hetimeve të rastit konkret.

Bojan Stojanovič – Doja të them se jemi të revoltuar për shkak të mungesës së z. Sheremet Ahmeti. Unë propozoj që të thirret Ministri z. Pajaziti dhe të zgjidhet ky rast se ku është përgjegjësia. Do ti pranoj dhe votoj të gjitha rekomandimet. Pa biseduar me Qeverinë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme nuk do të ketë efekt. Ne morëm vetëm informata që i kemi ditur. Mendoj se duhet të gjendet zgjidhja e duhur në këtë drejtim.

Melihate Termkollli – Unë mendoj se përgjegjësia duhet të kërkohet nga Qeveria dhe Ministri i Punëve të Brendshme.

Kryetari i Komisionit - tha, policia e Kosovës nuk është treguar e gatshme ti nënshtrohet kontrollit parlamentar dhe komisioni kërkon nga Ministri që të shkarkohet z. Sheremet Ahmeti. Do të ftojme Ministrin në mbledhje të komisionit me dyer të mbyllura. A pajtoheni që të thirret Ministri z. Zenun Pajaziti të premtën në mbledhje të komisionit?

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me këtë propozim.

Meqenëse nuk kishte pika tjera për të diskutuar, kryetari i komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Përgatiti:
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit

